



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 63 paragrafi 4 të Ligjit 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 6 paragrafi 5 të Rregullës nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.03.2018 merr këtë:

### V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit për pezullim

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për regjistrimin e partive politike dhe certifikim, që të shfuqizohet vendimi i pezullimit të partisë politike, "**Partia Republikane e Kosovës-PRK**".
- II. Obligohet Zyra që ta njoftojë përfaqësuesin e Partisë Politike "**Partia Republikane e Kosovës-PRK**" për marrjen e këtij vendimi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e saj të radhës, ka marrë vendim që të shfuqizojë vendimin e datës 2.03.2018 me nr protokolli 248/2018, për pezullim të partisë politike "**Partia Republikane e Kosovës-PRK**" pasi janë evituar arsyet që kanë shërbyer si bazë për pezullim dhe janë plotësuar kërkesat konform nenit 6 paragrafi 5 të Rregullës nr. 01/2013, për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

Partia Politike, ka mbajtur Kuvendin zgjedhor në afatin shtesë prej dyzet e pesë (45) ditëve, sipas vendimit të KQZ-së dhe ka përmbushur obligimet që dalin nga neni 15 Rregullës nr.01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive.

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete DAKA

